



Prishtinë, 20 gusht 2018
Kodi i ZRRE-së: V_102:1_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, 15, dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 13.11.2017 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2018;

në seancën e mbajtur me datë 20 gusht 2018, nxori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET dokumenti Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2018

Arsyetim

- 1) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 13 nëntor 2017 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit *Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2018* nga KOSTT Sh.A. Dokumenti është zhvilluar nga KOSTT duke u bazuar në Ligjin për Energji (L05/081).
- 2) MZHE, në bazë të nenit 8 të Ligjit për Energjinë ka analizuar dhe ka dhënë komentet e veta në veçanti lidhur me përshtatshmërinë e dokumentit me Strategjinë e Energjisë dhe programin e zbatimit të saj. Komentet e MZHE-së janë përfshirë në dokument dhe dokumenti është dërguar në ZRRE nga KOSTT për komentim dhe aprovim.
- 3) Në ndërkohë dokumenti ka pësuar ndryshime për shkak të problemeve me prodhim si pasojë e shpronësimit të mihjeve. Pas përfshirjes së komenteve dhe sugjerimeve dhe ndryshimeve që kanë rezultuar nga takime të përbashkëta, dokumenti është dërguar përfundimisht me datë 25.05.2018, si version final për aprovim në ZRRE.
- 4) Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Energjinë, ZRRE pas analizimit të dokumentit përfundimtar konsideron se dokumenti i përmbush kriteret për miratim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke miratuar dokumentin *Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2018*.



II. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë elektrike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti i përmbledhur i bilancit vjetor 2018 të energjisë elektrike dhe termike.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2018**

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së,

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar